

MISIONI I QEVERISJES VENDORE NË SHQIPËRI:

Qëllimi i vetëqeverisjes vendore në Shqipëri është të garantojë një qeverisje efikase në nivel sa më pranë qytetarëve përmes:

- 1 Njohja e ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të komuniteteve;
- 2 Respektimi dhe zbatimi i të drejtave themelore të qytetarëve të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje të tjera;
- 3 Përzgjedhja e llojeve të ndryshme të faciliteteve dhe shërbimeve publike vendore për përfitimin e komunitetit;
- 4 Ushtrimin efikas dhe efektiv të funksioneve, kompetencave dhe detyrave të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- 5 Kryerja e shërbimeve në forma të përshtatshme të bazuara në nevojat e komunitetit dhe në përputhje me standardet e vendosura nga ligji kombëtar ose aktet e tjera normative;
- 6 Promovimi efektiv i pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qytetarëve në qeverisjen vendore dhe ofrimi i shërbimeve cilësore.

FUNKSIONET E BASHKIVE SIPAS SFERËS SË AKTIVITETIT DHE TIPOLOGJISË SË SHËRBIMEVE VENDORE:



BASHKITË PËR NË EVROPË
Një projekt i financuar nga BE

QEVERIA VENDORE NË NIVELIN EVROPIAN DHE ATË SHQIPTAR.

"Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian, përmbajtja e të cilit është përgjegjësi e vetme e projektit të Bashkisë për Evropë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian"

Për më shumë informacion mbi këtë projekt, ju lutem vizitoni faqen: www.bpe.al

E ARDHMJA E EVROPËS MBËSHTETET TEK TERRITORET E SAJ.

Mbi 60%* e vendimeve të marra në nivelin Evropian kanë ndikim të drejtpërdrejtë në bashkitë, krahinat dhe rajonet vendore dhe rreth 75% e investimeve publike në Evropë bëhen nga autoritetet vendore dhe rajonale. Këto dy shifra të vetme janë dëshmi e rëndësisë gjithnjë e më në rritje të qeverisë vendore dhe rajonale Evropiane si në ekonominë e sotme botërore dhe në jetën e qytetarëve tanë.



60 VITE EVROPË VENDORE DHE RAJONALE

Në vitin 1951, një grup i përbërë nga disa kryetarë bashkish krijuan atë që më pas do quhej Këshilli i Bashkive Evropiane (CEM). Sot, këta kryetarë bashkish mund të quhen paraardhësit e Bashkimit Evropian. Qëllimi i tyre në themelimin e Këshillit të Bashkive Evropiane ishte krijimi i një Evrope të bashkuar dhe paqësore, bazuar në parimet e vetëqeverisjes vendore dhe rajonale, të krijuara nga dhe me qytetarët, qytetet dhe fshatrat e saj

LINDJA E DEMOKRACISË VENDORE

Në Asamblenë e parë të përgjithshme të Këshillit të Bashkive Evropiane në vitin 1953, përfaqësuesit vendorë të zgjedhur nga disa vende të Evropës miratuan 'Kartën Evropiane të Lirive Vendore', një tekst i cili listonte të drejtat e qyteteve, fshatrave, dhe bashkive, kundrejt qeverive qendrore.

Tridhjetë vjet më vonë, Këshilli i Evropës miratoi Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, e cila u frymëzua shumë nga Karta e Lirive Vendore (CEM) dhe aktualisht është ratifikuar nga 45 prej 47 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Shqipëria është anëtare e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve Evropiane (KBRE) (CEMR).

REFORMA E FUNDIT TERRITORIALE NË SHQIPËRI

Njësoj si shumë shtete të tjera të Evropës, pas një sërë legjislacionesh dhe aktesh rregullatore, Shqipëria ndërmori në vitin 2014, një reformë të konsolidimit territorial nën të cilën rajonet tashmë përbëhen nga afërsisht pesë bashki dhe njësitë e qeverisjes vendore u reduktuan nga 308 komuna dhe 65 bashki në vetëm 61 bashki në total.

CILËT JANË VENDIMMARRËSIT KRYESORË NË NIVEL VENDOR NË SHQIPËRI?

Këshilli Bashkiak është organi vendimmarrës i pushtetit vendor. Anëtarët e saj zgjidhen me votim të drejtpërdrejtë për një mandat katër vjeçar. Këshilli i Bashkiak është përgjegjës për taksat vendore dhe për miratimin e planeve e rregulloreve. Kryetari është organi ekzekutiv i bashkisë dhe zgjidhet me votim të drejtpërdrejtë për një mandat katërvjeçar. Ai miraton dhe zbaton vendimet e këshillit bashkiak, garanton që të gjitha detyrimet e autoritetit vendor të jenë plotësuar dhe përfaqëson bashkinë kundrejt palëve të treta.



* - *Broshura "Qeverisja vendore dhe rajonale në Evropë. Struktura dhe Kompetencat", -prodhuar nga KBRE "Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane"(CEMR "Council of European Municipalities and Regions)